



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
MAIN FAMILY MEDICAL CENTRE
"Dr. SHPËTIM ROBaj"
MALISHEVË
Nr. 150
Data: 24. 02. 2021



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL -MALISHEVË/QKMF "Dr. SHPËTIM ROBaj" NË MALISHEVË

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 Komuna e Malishevës - QKMF "dr. Shpëtim Robaj" shpall:

K O N K U R S PËR PLOTSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

Titulli i vendit të punës: Mjek/e i/ e Përgjithshëm/e në QKMF-"Dr: Shpëtim Robaj"

- Mjek/e i/e Përgjithshëm/e 6 pozita te lira

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(6) gjashtë.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koefficienti	7.2- H 27
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese	Gjashtë (6) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë për mjek/e i/e përgjithshëm

- Ofron shërbime me standardë të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi.
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për pacientin nën mbikëqyrjen e mjekut familjar.
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrjen e Mjekut Familjar.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë
- Kujdesi për personat në nevojë
- Edukimi shëndetësor etj.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma e fakultetit të mjekësisë drejtimi i përgjithshëm
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar nga MASHT.
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezymeja personale (CV)
- Licencën e punës, (kopje)
- Certifikatën e lindjes,
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i dënuar (origjinali).
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Certifikatën e mjekut për punë (pas përzgjedhjes nga komisioni)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë.

Aplikacionet dorëzohen nga data 26.03.2021 deri me dt: 12.04.2021 Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit në QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

Rezultatet shpallen në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net>

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

QKMF-Malishevë.

Drejtori:
Dr: Nuhi Morina spc. Pediatër

